



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit, nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE TË ADMINISTRATËS**

1. Miratohet Vendimi për ndarjen e subvencioneve të administratës.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, shuma e mjeteve të ndara është në vlerë prej 360,250.00 €, shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme.
3. Sipas pikës 2 të këtij vendimi, përfituesit e ndarjës së subvencioneve janë:
  - OJQ "Handikos", 10,000.00 €,
  - Teatri i të Rinjve të Qytetit, 7,000.00 €,
  - Kërkesa për ndihmë nga z.Gani Latifi, pas djegies së shtëpisë si pasojë e rrufesë, 10,000.00 €
  - Shoqata e Pensionistëve, 35,000.00 €,
  - Studentit për studime jashtë vendit, 5,000.00 €,
  - Klubit të Pin-pongut, "Priping", Prishtinë, 4,000.00 €,
  - Federata e Karatesë, Prishtinë, 4,000.00 €,
  - Plisat & Dardanët, 2x3,500.00 €, gjithsej 7,000.00 €,
  - OJQ "SpaceSynTax", 9,000.00 €,
  - Federata e Xhudos, Prishtinë, 4,000.00 €,
  - KFF EP-COM Hajvalia/ Klubit të Futbollit të Femrave, 4,000.00 €,
  - Ndihma për dru, rasteve sociale/ komuniteteve, 3 metra kub dru për familje, 1045 familje x 250 € = 261,250.00 €.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Financave e Komunës së Prishtinës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
**01-450/03-257594/22, më 25.11.2022**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Fehmi Kupina**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 381(0)38/230-900  
<http://www.prishtina-komuna.org>